

# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

---

Për: **Kuvendi Komunal Lipjan**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **613-26-670-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Llot 1 - Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e Administratës, Qendra për Punë Sociale, Arkivi i Qytetit dhe Zona Ekonomike në Qylagë**

---

## ANKESË

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**SKYFTERAT-LIVE SH.P.K.**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**RR.REXHEP BISLIMI NR.1**

*(Adresa)*

**FERIZAJ**

*(Vendi)*

**70 000**

*(Kodi postar)*

**048/100-800**

*(Numri Telefonit)*

**NUK APLIKOHET**

*(Numri i Faks-it)*

**NJAZI SYLA**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

[skyfterat-live@hotmail.com](mailto:skyfterat-live@hotmail.com)

*(Adresa elektronike)*

**03.07.2026**

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

---

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

---

*(Emri i avokatit)*

---

*(Adresa e plotë)*

---

*(Numri i Telefonit)*

---

*(Numri i faks-it)*

---

*(Adresa elektronike)*

---

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

---

*(Nënshkrimi dhe vula)*

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Lënda: Shërbime

Procedura e prokurimit: *Procedurë e hapur*

FPP fjalori kryesor: 75222000-8 Shërbimet civile të mbrojtjes

Vlera e parashikuar: 335,000.00€ (e madhe)

#### **B05 Njoftimi për Kontratë**

Data: 23.02.2026 09:52

#### **B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara**

Data: 09.03.2026 10:19

#### **B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara**

Data: 30.03.2026 14:39

#### **B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara**

Data: 02.04.2026 15:10

#### **B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara**

Data: 08.04.2026 15:49

#### **B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara**

Data: 29.04.2026 11:07

#### **Afati për dorëzimin e tenderëve:**

Data: 12.05.2026–Ora:14:00

#### **► Hapja e ofertave– Procesverbali i hapjes:**

Data: 12.05.2026 14:27

#### **Njoftimi mbi vendimin e AK-së:**

Data: 18.06.2026 15:47

#### **Kriteri për dhënien e kontratës:**

√ Çmimi më i ulët

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifíkoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

**Jo, nuk kemi marr pjesë, hapja e ofertave është bërë në mënyrë elektronike përmes platformës së E-prokurimit.**

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

**Po, e kemi pranuar letrën standarde përmes publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së me datën 18.06.2026.**

#### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

##### **-Legjislacionet-**

##### **1. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092.**

- Neni 1-Qëllimi,
- Neni 6-Ekonomiciteti dhe efikasiteti,
- Neni 7-Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,
- Neni 10 -Mjetet për promovimin e Transparencës,
- Neni 31-Ekzekutimi i kontratave,
- Neni 51-Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes,
- Neni 52-Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës,
- Neni 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

## 2. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

- Neni 17 -Dosja e tenderit,
- Neni 25-Kriteret e përzgjedhjes,
- Neni 27-Kriteret e dhënies së kontratës,
- Neni 38-Sqarimi i Tenderëve,
- Neni 40-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,
- Neni 45-Procedura e Hapur.

## 3. Ligji i Punës Nr.03/L-212

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës suaj.*

I nderuar Panel Shqyrtues – OSHP

Pas publikimit të parë të **B58 Njoftimi për mbi vendimin e AK-së** me datën 18.06.2026 si palë e interesuar konform **Nenit 4 par.1.26 të LPP-së**, kemi bërë fillimisht kërkesë për qasje në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe dokumentet e aktivitetit të prokurimit.

Me datën 23.06.2026, pasi që nuk kemi qenë të kënaqur me vendimin e publikuar të AK-së, kemi paraqitur konform rregullave dhe Nenit 108/A të LPP-së kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

Pas analizimit të thellë të dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë, si dhe dosjes së korigjuar kemi vërejtur disa rrethana faktike që përbëjnë supozimin tonë për shkeljen e dispozitave të LPP-së gjatë fazës së vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave, ku konsiderojmë se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

### **RRETHANAT E ÇËSHTJES DHE KRONOLOGJIA E NGJARJEVE**

#### **2.1 Paralajmërimet e hershme rreth vlerës së pamjaftueshme të kontratës**

Që në fazën e sqarimeve, disa operatorë ekonomikë kishin ngritur shqetësime serioze lidhur me vlerën e parashikuar të kontratës.

**Më datë 09.03.2026, ora 09:56**, kompanitë u ankuan nëpërmjet platformës elektronike (e-prokurimi.rks-gov.net) se vlera e parashikuar e kontratës nuk përputhej me kërkesat e dosjes së tenderit. AK bëri korigjim të vlerës duke e rritur atë.

Megjithatë, **më datë 11.03.2026, ora 09:44**, AK publikon sqarimin e radhës ku persëri kishte të njëjtën ankesë: vlera e korigjuar mbetej e pamjaftueshme për ekzekutimin e kontratës sipas kërkesave. AK mbështeti vlerën e korigjuar duke menduar se vlera ishte e mjaftueshme dhe vazhdoi me hapjen e ofertave.

## 2.2 Kërkesat për rishqyrtim kundër dosjes së tenderit

Prej datave **27.03.2026 deri më 16.04.2026**, AK pranoi disa kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, tema qendrore e të cilave ishte mos-llogaritja e shtesave të obligueshme sipas **Nenit 56 të Ligjit të Punës** (pune nate, fundjavë, festa).

AK i refuzoi të gjitha këto kërkesa, duke lënë anash argumentet thelbësore.

## 2.3 Sqarimi zyrtar i AK-së kundrejt praktikës reale

Më datë **08.04.2026, ora 14:01**, AK iu përgjigj një pyetjeje të Operatorit Ekonomik lidhur me analizën financiare dhe llogaritjen e shtesave të Ligjit të Punës si vijon:

*"...ju informojmë se të gjitha kërkesat të cilat janë të parapara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, duhet të respektohen dhe përmbushen nga ana e operatorëve ekonomikë."*

Kjo deklaratë e qartë e AK-së tregon se AK vetë kishte pranuar detyrimin e respektimit të të gjitha kërkesave të dosjes gjatë vlerësimit. Megjithatë, **AK nuk ka vepruar konform kësaj deklarate gjatë vlerësimit të ofertave**, siç do të dëshmohet më poshtë.

## **SHKELJET E KONSTATUARA**

### 3.1 Shkelja e parë – Ofertuesi i rekomanduar nuk mund të ekzekutojë kontratën sipas çmimit të ofruar

Dosja e tenderit, **Kërkesa nr. 2**, kërkon që çdo Operator Ekonomik të paraqesë një Deklaratë dhe Analizë Financiare që të përfshijë: Pagën bazë 500.00 € bruto për punëtor + Pushimet vjetore + Kontributet pensionale 5% (punëdhënësi) + Fitimin e kompanisë + TVSH 18%.

Grupi i rekomanduar për kontratë **MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.** ka ofruar vlerën **264,614.40 EUR me TVSH** për Llot 1, e cila llogaritet si e pamjaftueshme për ekzekutimin e kontratës sipas kalkulimit të detajuar të mëposhtëm:

Përshkrimi	Llogaritja	Vlera (EUR)
Paga bazë bruto (500 € x 17 punëtorë)	17 x 500.00 €	8,500.00 €/muaj
Kontributi pensional i punëdhënësit (5%)	17 x 25.00 €	425.00 €/muaj
Totali mujor pa TVSH	17 x 525.00 €	8,925.00 €/muaj
Totali 24 muaj pa TVSH	8,925.00 x 24	214,200.00 €
TVSH 18%	214,200.00 x 18%	38,556.00 €
<b>TOTALI BAZË (pa pagesat për shtesa pune nate/fundjavë/festa)</b>		<b>252,756.00 €</b>
<b>OE FITUES - MEB L.L.C. &amp; KSF MAJOR SH.A.</b>		<b>264,614.40 €</b>

Kjo analizë tregon qartë se vlera minimale e kostove për 17 punëtorë me pagë bazë 500 € bruto gjatë 24 muajve arrin në **252,756.00 EUR**, pa llogaritur asnjë pagesë shtesë të obligueshme sipas Ligjit të Punës, pa asnjë fitim të kompanisë dhe pa asnjë kosto operative tjetër. Vlera e ofertuar e **264,614.40 EUR** lë një margjinë prej vetëm rreth **11,858.40 EUR** për shtesa pune nate/fundjavë/festa, pushime vjetore dhe fitim të kompanisë për 24 muaj sa është edhe kohëzgjatja e kontratës – gjë që është **haptazi e pamundur** sipas kushteve dhe orarit të kërkuar nga dosja e tenderit.

### 3.2 Shkelja e dytë – Mosrespektimi i nenit 56 të Ligjit të Punës dhe kërkesave të dosjes

Dosja e tenderit kërkon realizimin e shërbimit me oraret si vijon (Kërkesa 5, Aneksi 1):

- Sigurimi fizik – Auto parku (oborri dhe rampa): 24 orë / 7 ditë të javës
- Sigurimi fizik – Qendra për Punë Sociale, Lipjan: 24 orë / 7 ditë të javës
- Sigurimi fizik – Ndërtesa e Komunës Lipjan: 08:00–16:00 / 5 ditë të javës
- Sigurimi fizik – Arkivi i Qytetit, Lipjan: 16:00–08:00 / 7 ditë në javë
- Sigurimi fizik – Zona Ekonomike në Qylagë: 16:00–08:00 / 7 ditë në javë

Sipas **Aneksit 1 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme**, dosja e tenderit shprehimisht detyron zbatimin e **Ligjit të Punës Nr. 03/L-212** dhe **Ligjit për Shërbime Private të Sigurisë Nr. 04/L-004**. Konkretisht, sipas Ligjit të Punës:

- Neni 27 – Orët ndërmjet 22:00 dhe 06:00 konsiderohen punë nate;
- Neni 56 – Punëmarrësit i takon paga shtesë: 30% në orë për punë gjatë natës; 50% në orë për punë gjatë ditëve të festave; 50% në orë për punë gjatë fundjavës.

Oraret e kërkuara nga dosja e tenderit, sidomos shërbimi 24/7 për dy pozicione dhe orari 16:00–08:00 për dy pozicione të tjera, **detyrimisht përfshijnë punë gjatë natës, fundjavave dhe festave**. Shtesa e obligueshme ligjore për punë nate (30%), fundjavë dhe festa (50%) mund të rrisë ndjeshëm koston totale të pagave, duke e bërë **ofertën e MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A. krejtësisht të pabesueshme dhe të paekzekutueshme**, pasi marzha e tyre e disponueshme prej rreth 11,858.00 EUR nuk mund të mbulojë asnjëherë këto shpenzime.

Ky konstatim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me **Nenin 31 të LPP-së**, i cili detyron AK-në të sigurojë që ofertat e pranuar janë të besueshme dhe ekonomikisht të realizueshme, si dhe me **sqarimin zyrtar të AK-së të datës 08.04.2026**, ku vetë AK kishte konfirmuar detyrimin e respektimit të këtyre kërkesave.

### 3.3 Shkelja e tretë – Ofertuesit tjerë që nuk mund të ekzekutojë kontratën sipas çmimit të ofruar

Oferta e SKYFTERAT-LIVE SH.P.K. ka qenë: 335,946.24 Euro.

Ndërsa ofertat më të ulëta kanë qenë:

- MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A. – 264,614.40 Euro
- International Security AAH – 271,495.68 Euro
- Security Code – 276,134.40 Euro
- Scorpion Group – 273,043.20 Euro

**Nga krahasimi i çmimeve rezulton se të gjitha ofertat e lartcekura janë dukshëm nën vlerën reale të kontratës dhe nuk arrijnë të mbulojnë:**

- pagën bazë të kërkuar;
- kontributet pensionale;
- pushimet vjetore;
- **shtesat sipas Nenit 56 të Ligjit të Punës;**
- shpenzimet operative;
- fitimin e kompanisë.

Për pasojë, këto oferta nuk mund të konsiderohen oferta të përgjegjshme sipas nenit 59 të LPP-së.

### **3.4 Shkelja e katërt – Mosverifikimi i vërtetësisë së dokumentacionit të Operatorit Ekonomik**

Autoriteti Kontraktues nuk ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga grupi i OE-ve të rekomanduar, duke shkelur **Nenin 26.16 të Rregullores Nr. 001/2022**, i cili shprehimisht parasheh se:

*"Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek autoriteti/personi fizik përkatës."*

Konkretisht, Ankuesi ka arsye të besueshme të mendojë se kompania **MEB L.L.C. nga Prizreni** ka paraqitur tek AK një **marrëveshje me këste me ATK-në të datës 28.03.2025**, e cila kishte afat 12 muaj (deri rreth 28.03.2026). Sipas orarit të pagesave të kësaj marrëveshje, obligimet ndaj ATK-së duhet të ishin shlyer tërësisht brenda kësaj periudhe dhe jo të mbetet akoma në obligim (borxhe).

Megjithatë, të dhënat publike të ATK-së tregojnë se kompania **figuron ende si borxhli në sistemin e ATK-së**, me vërejtjen: *"personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura"*. Ky fakt ngre dyshimin serioz se kompania ka hyrë në **marrëveshje të re** pas datës së njoftimit për kontratë dhe ka paraqitur marrëveshjen e vjetër (të skaduar ose të pa-përmbushur) tek AK, me qëllim lajthitjen e tij.

AK kishte në dispozicion mundësinë e verifikimit online të statusit tatimor të kompanisë nëpërmjet platformës publike të ATK-së ([www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)). Ky verifikim do të kishte zbuluar pamjaftueshmërinë e dokumentacionit të paraqitur. Mosveprimi i AK-së përbën shkelje të **Nenin 26.16 të Rregullores Nr. 001/2022**, i cili e bën të detyrueshëm verifikimin efektiv kur dyshohet vërtetësia e informacionit.

Për verifikimin e kësaj shkelje, AK mund të kontaktojë direkt Administratën Tatimore të Kosovës:

- Departamenti Mbledhja e Borxheve:  
Tel. +383 38 222 167 203 | Email: info@atk-ks.org
- DTM: Afrim Kqiku:  
Tel: +383 200 255 97 | Email: Afrim.Kqiku@atk-ks.org

### **3.5 Shkelja e pestë – Moslejimi i qasjes në ofertën e OE-ve të rekomanduar**

Ankuesi konstaton se **AK nuk ka lejuar qasje në ofertën e grupit të rekomanduar për kontratë (MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.) për Llot 1.**

Ky veprim pengon Ankuesin nga verifikimi i plotë i konformitetit të ofertës me kërkesat e dosjes dhe mund të fshehtë shkelje shtesë. Moslejimi i qasjes bie ndesh me parimin e transparencës si vlerë themelore e prokurimit publik.

### **3.6 Shkelja e gjashtë – Mosverifikimi i kritereve të pranueshmërisë**

AK nuk ka kryer vërtetimet e nevojshme të pranueshmërisë (si ato nga ATK dhe Gjykata) për OE-të e rekomanduar. Sipas LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, AK ka detyrimin të verifikojë plotësisht kriteret e pranueshmërisë para rekomandimit të kontratës.

Verifikimi sipërfaqësor i dokumentacionit të paraqitur, pa kontrollimin e vërtetësisë tek autoritetet kompetente, nuk përmbush standardet ligjore të prokurimit publik.

## **KËRKESA**

Duke u bazuar në nenin 108/A të LPP-së, kërkojmë nga OSHP që:

1. **Të anulojë Njoftimin mbi vendimin AK-së.**
2. **Të kthejë lëndën në Rivlerësim sipas dispozitave të LPP-së.**
3. **Të detyroj ti vlerësoj ofertat konform Nenit 59.4 të LPP-së, sipas NjK dhe DT - në vend të eliminimit të qëllimshëm për favorizim të operatorit të caktuar.**

## **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Neve si palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit na janë krijuar shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë aktivitet të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat mund të ndodhin etj.**

**Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.**

## **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.